

VENDIM
Nr. 69, datë 22.4.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “GSA” SHPK, PËR ZGJATJE TË AFATIT TË PËRFUNDIMIT TË PROCEDURËS SË SHQYRTIMIT TË KËRKESËS, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË GAZIT NATYROR

Në mbështetje të nenit 22, pika 2, germa “c”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të nenit 53, pikat 1 dhe 3, neneve 91 dhe 92, pikat 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; dhe të nenit 24, pika 1, të “Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 22.4.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për shtyrje të afatit të vendimmarrjes finale të Bordit të ERE-s”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 6, datë 10.1.2020, ka vendosur fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Me shkresën nr. 62/1 prot., datë 14.1.2020, u krye njoftimi në medien e shkruar, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë GSA sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Me shkresat nr. 41 prot., datë 14.1.2020 dhe nr. 41/1, datë 11.2.2020, ERE njoftoi shoqërinë për dokumentacionin e munguar apo nevojën për informacion shtesë të konstatuar në dosjen e aplikimit.

- Dokumentacioni, i cili u konstatua në mungesë apo për plotësim, konsistonte si vijon:

Neni 9, pika 1, “Forma e aplikimit”:

Germa “d” (Dokumentacioni ligjor, administrativ dhe pronësor): plotësuar pjesërisht;

Germa “e” (Dokumentacioni dhe garancitë financiare dhe fiskale):

- i. Bilancet financiare të audituara nga një shoqëri audituese e akredituar, për secilin prej tri viteve të fundit që paraprijnë paraqitjen e aplikimit: Shoqëria duhet të plotësojë aplikimin e të depozitojë në ERE edhe pasqyrat financiare të audituara për vitin 2016;

- vi. Një plan biznesi i cili përfshin një analizë të kostove dhe të përfitimeve, përfshirë kostot për largimin përfundimtar të pajisjeve dhe rehabilitimin e mjedisit me përfundimin e operacioneve): Shoqëria nuk ka depozituar një plan biznesi në mbështetje të kësaj kërkesë;

- vii. Nëse aplikanti ka synim të përdorë një shoqëri menaxhimi për operacionet e tij ditore, ai duhet të informojë ERE-n për këtë synim dhe të japë një garanci të performancës për kryerjen me ndershmëri dhe besueshmëri të veprimeve prej kësaj shoqërie menaxhimi: Nuk është dhënë informacion mbi këtë kërkesë.

2. Dokumente specifike për llojin e licencës:

- ii. Kapitalin financiar të nevojshëm për kryerjen e aktivitetit që kërkohet dhe, në veçanti, për të mbuluar ekspozimin financiar të shkaktuar prej balancimit të gazit: Shoqëria ka depozituar në ERE vërtetimin bankar mbi gjendjen e llogarisë bankare të shoqërisë, pa saktësuar vlerën e përcaktuar nga shoqëria për garantimin e ushtrimit të aktivitetit të furnizimit dhe atë të tregimit për ushtrimin e të cilit ka aplikuar në ERE.

- Me komunikimin elektronik të datës 3.4.2020, për shkak të kufizimeve dhe situatës së krijuar nga COVID-19, shoqëria ka paraqitur kërkesë për shtyrje të afatit të plotësimit të dokumentacionit deri në normalizimin e gjendjes.

- Shoqëria “GSA” sh.p.k. e ka plotësuar kryesisht dokumentacion e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin ose heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 4.7.2017, si dhe ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për aplikim për licencim në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror.

- Kërkesa e shoqërisë për shtyrje të afatit të depozitimit të dokumentacionit të munguar, në kushtet e situatës së krijuar nga përhapja e epidemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19 dhe kufizimet e vendosura në të gjithë vendin, me qëllim parandalimin e përhapjes së kësaj sëmundjeje, është e ligjshme.

- Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 24.3.2020, “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, janë vendosur kufizime të lirive kushtetuese, të tilla që vështirësojnë lëvizjen e përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara për aplikuesin në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 10.1.2020.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, “Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit COVID-19 dhe të shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë”, është vendosur për: Pezullimin e zbatimit të nenit 9, pika 2, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me vendimin e Bordit nr. 215/2019, si dhe të nenit 9, pika 1, germa “d”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e gazit natyror”, miratuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 97, datë 4.7.2017.

- Në mbështetje të nenit 92, pikat 1 dhe 2, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, ERE ka kompetencën të shqyrtojë dhe të shprehet në lidhje me kërkesën për shtyrjen e afatit të një procedure nën autoritetin e saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë me 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarike afatin e përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të gazit natyror, duke filluar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti